

Raportet e Shtetit mbi terrorizmin për vitin 2019: KOSOVA

24 qershor 2020

Përmbledhje: Kosova vazhdoi ta luftojë kërcënimin e terrorizmit përmes bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara. Kosova është anëtare e Koalicionit Global për mposhtjen e ISIS-it. Qeveria e Kosovës (QK) po i afrohet fundit të kornizës kohore të parashikuar nga strategjia e saj gjithëpërfshirëse e CVE-së (kundërvënja ekstremizmit të dhunshëm) dhe është duke përgatitur një strategji të re gjithëpërfshirëse dhe një plan veprimi për qeverinë në ardhje për ta shqyrtuar për periudhën 2020-2025.

Më 20 prill, me ndihmën e SHBA-së, Kosova riatdhesoi katër të dyshuar FTF (luftëtarë terroristë të huaj) dhe 106 anëtarë të familjeve nga Siria, duke u bërë kështu një nga vendet e para që ktheu një numër të madh të civilëve nga zona e konfliktit. Tre prej katër FTF-ve të supozuar u mbajtën në paraburgim, ndërsa i katërti, një 18-vjeçar, u lirua dhe do të hetohet si i mitur. Gratë dhe fëmijët, pas kohës së ndalimit fillestar prej 72 orësh për t'i kryer kontrollet e shëndetit fizik dhe mendor, u kthyen në familjet dhe komunitetet e tyre. QK-ja i trajtoi profesionalisht kthimet gjatë kohës së ndalimit fillestar prej 72 orësh. Ndonëse Qeveria drejton një Divizion për Parandalim dhe Ri-integrim në kuadër të Ministrinë së Punëve të Brendshme, burimet dhe kapacitetet e kufizuara vazhdojnë ta pengojnë aftësinë e qeverisë për t'u ofruar të kthyerve shërbime dhe ndihmë përkatëse.

Incidentet terroriste në vitin 2019: Nuk ka pasur incidente terroriste të raportuara në Kosovë në vitin 2019.

Legjislacioni, zbatimi i ligjit dhe siguria kufitare: Korniza legjislative e Kosovës mjafton për t'i ndjekur penalisht individët të cilët dyshohen se kanë kryer ose mbështesin aktivitete terroriste, por mungon zbatimi i saj, posaçërisht me dënime të shkurta, lirim të parakohshëm nga burgu dhe mungesë të mbikëqyrjes pas lirimit. Kosova mbështet zbatimin e Rezolutës 2396 të KSKB-së për t'iu kundërvënë udhëtimit terrorist dhe po punon për ta zbatuar atë në praktikë.

Më 4 shtator, Gjykata Themelore e Prishtinës dënoi gjashtë të pandehur për planifikim të sulmeve terroriste në Kosovë, Shqipëri, Belgjikë, Francë dhe Maqedoni të Veriut, përfshirë edhe bomba të planifikuara vetëvrasëse në Kosovë kundër trupave të KFOR-it, klubeve të natës dhe kishave ortodokse serbe ndërmjet dhjetorit të vitit 2017 dhe qershorit të vitit 2018. I pandehuri kryesor u dënua me 10 vjet burg. Të pandehurit e tjerë morën dënime më të vogla, megjithatë domethënëse. Ky rast pasoi pas muajve të tërë të operacioneve të Policisë së Kosovës dhe të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë me ndihmë të konsiderueshme hetimore dhe prokuroriale të SHBA-së, përfshirë gjurmimin e përpjekjeve për blerje të armëve.

Më 7 nëntor, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ngriti akuza në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, kundër të parit prej katër FTF-ve të dyshuar, që ishin riatdhesuar nga Siria në prill. Prokurorët dhe hetuesit po i përdorin provat e fushëbetesës, të siguruar nga një agjenci amerikane për FTF-të e dyshuar dhe disa gra. FTF-ja u deklarua fajtor për pjesëmarrje në një grup terrorist dhe u dënua me katër vjet burg, përfshirë kohën e kaluar në paraburgim. Falë pranimit të fajit, dënimi paraqiste një largim të lejueshëm nën dënimin minimal sipas ligjit të Kosovës (pesë vjet). I dyshuari i dytë FTF u akuzua më 10 dhjetor.

Në vitin 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës pranoi pranimin e fajit për pjesëmarrje në një grup terrorist nga dy prej grave të kthyera nga Siria, duke i dënuar secilën me kusht. Sipas kushteve të dënimeve të tyre, gratë nuk do ta vuajnë dënimin në burg nëse nuk kryejnë krime të tjera, paraqiten rregullisht në polici dhe i vijnë seancat e detyrueshme të psikoterapisë. Në nëntor, aktakuza të ngjashme u ngritën kundër katër grave të kthyera dhe tri gra të tjera u akuzuan në dhjetor.

Më 18 nëntor, PSRK-ja akuzoi një qytetar të Kosovës për nxitje për të kryer veprë terroriste pasi individi publikoi mbështetje të hapur dhe u mburr për sulmet terroriste në Sri Lankë përmes mediave sociale.

Më 27 qershor, Presidenti Thaçi nxori një dekret që i detyronte institucionet e sigurisë të Kosovës ta krijojnë një listë të brendshme të personave, grupeve dhe organizatave të përfshira në terrorizëm, që do t'u nënshtroheshin masave kufizuese në vend. Presidenti Thaçi deklaroi se derisa të krijohet një listë e tillë brenda vendit, institucionet e sigurisë të Kosovës do ta zbatojnë listën e BE-së, e cila përfshin Hezbollahun.

Kundërvënia financimit të terrorizmit: Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës (NJIF) është anëtare e Grupit Egmont. Nuk pati ndonjë azhurnim domethënës në vitin 2019.

Kundërvënia ekstremizmit të dhunshëm: Strategjia dhe plani për veprim CVE i Kosovës (2015-2020) ofron një hartë rrugore pesëvjeçare për ta penguar kërcënimin në rritje e sipër të terrorizmit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse të qeverisë, duke theksuar rolin vendimtar të palëve të interesuara lokale dhe të shoqërisë civile. Zbatimi nuk ka qenë i njëjlojtë në ministrinë e qeverisë dhe sfidat vazhdojnë për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe burimeve të pamjaftueshme. Një grup punues ndërministror është duke hartuar një strategji të rishikuar për radikalizimin kundër terrorizmit dhe rekrutimin për t'u përqendruar në riintegrimin e të kthyerve.

Ministria e Drejtësisë e Kosovës vazhdoi zbatimin e një programi korigjues – e ndihmuar nga ekspertë të SHBA-së – që synon përmirësimin e menaxhimit të terroristëve në burgje; mbledhjen, analizimin dhe ndarjen e inteligjencës së burgut brenda organeve për zbatim të ligjit; dhe menaxhimin e rehabilitimit dhe riintegrimin eventual të terroristëve të dënuar. Sektori për Parandalim dhe Riintegrim i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka për detyrë t'i riintegrojë individët që e kanë vuajtur dënimin me burg nën akuzat për terrorizëm, FTF-të e kthyer dhe anëtarët e familjeve – përfshirë përmes financimit të trajtimit të shëndetit mendor dhe lehtësimit të qasjes në shërbime sociale – por ai vuan nga personeli dhe burimet e pamjaftueshme.

Organizatave të Kosovës vazhduan aktivitetet bashkëpunuese përmes Mekanizmit Mbështetës të Vendit nën GCERF, një fond global publiko-privat për t'i mbështetur përpjekjet lokale, bazike kundër radikalizimit dhe rekrutimit në komunitetet në rrezik.

Ferizaj, Gjakova, Gjilani, Graçanica, Hani i Elezit, Kaçaniku, Mitrovica jugore, Peja, Prishtina, Prizreni, Vitia, Vushtrria dhe Zveçani janë anëtarë të SCN-së.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal: Qeveria e Kosovës ka punuar ngushtë me zyrtarët në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut për ta mbështetur ndërtimin e kapaciteteve kundër terrorizmit dhe bashkëpunimin rajonal.